

PËRMBAJTJA:

| | FAQE |
|---|-------------|
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 2 |
| PASQYRA E PERFORMANCËS | 3 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 4 |
| PASQYRA E FLUKSIT TË MJETAVE MONETARE | 5 |
| SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE | 6 - 17 |

FL

RINA ALBANIA Sh.p.k.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

| | Shënime | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|----------------|------------------------|------------------------|
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 4 | 10,218,356 | 4,439,244 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 5 | 2,013,035 | 4,048,291 |
| Të tjera llogari të arkëtueshme | 6 | 1,072,387 | 1,003,700 |
| Parapagime dhe Shpenzime të shtyra | 7 | 26,057 | 24,249 |
| Total aktive afatshkurtra | | 13,329,834 | 9,515,484 |
| Aktivët afatgjata | | | |
| Të tjera llogari të arkëtueshme afatgjata | 8 | 158,808 | 158,808 |
| Aktive afatgjata materiale | 9 | 279,065 | 250,178 |
| Total aktive afatgjata | | 437,873 | 408,986 |
| Total Aktive | | 13,767,707 | 9,924,470 |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 10 | 9,304,386 | 9,170,038 |
| Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 11 | 11,448,854 | 9,787,459 |
| Të tjera detyrime | 12 | 34,103 | - |
| Detyrime tatimore | 13 | 409,968 | 286,775 |
| Total Detyrime afatshkurtra | | 21,197,312 | 19,244,273 |
| Hua Afat-gjata | 14 | 11,494,550 | 11,668,800 |
| Total Detyrime afatgjata | | 11,494,550 | 11,668,800 |
| Totali i detyrimeve | | 32,691,862 | 30,913,073 |
| Kapitali | | | |
| Kapitali nënshkruar | | 1,500,000 | 1,500,000 |
| Rezerva ligjore | | 150,000 | 150,000 |
| Humbje të mbartura | | (22,638,603) | (15,656,561) |
| Fitim i ushtrimit | | 2,064,448 | (6,982,042) |
| Total kapitali | 15 | (18,924,155) | (20,988,603) |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | | 13,767,707 | 9,924,470 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RINA ALBANIA Sh.p.k.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

| Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|---|--|--|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 16 | 16,071,979 |
| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | 17 | (16,320) |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | (10,102,034) | (6,337,274) |
| Lënda e parë dhe materiale të | | |
| 1) konsumueshme | | |
| 2) Të tjera shpenzime | 18 | (10,102,034) |
| Shpenzime të personelit | 19 | (2,156,126) |
| 1) Paga dhe shpërblime | | (1,793,805) |
| Shpenzime të sigurimeve | | |
| 2) shoqërorë/shëndetësore | | (362,321) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 20 | (53,523) |
| Shpenzime të tjera të shfrytëzimit | 21 | (1,853,777) |
| Shpenzime financiare | 22 | 174,250 |
| 2) Shpenzime të tjera financiare | | 174,250 |
| Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet | | |
| Fitimi/humbja para tatimit | 23 | 2,064,448 |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | - |
| 1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | - |
| Fitimi/humbja e vitit | | 2,064,448 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin: | | - |
| Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin | | - |
| Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin | | 2,064,448 |
| | | (6,982,042) |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RINA ALBANIA Sh.p.k.
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

| | Kapitali themelues | Rezerva Ligjore | Fitime/(humbje) të mbartura | Fitimi/(humbja) e ushtrimit | Total |
|--|--------------------|-----------------|-----------------------------|-----------------------------|---------------------|
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014 | 1,500,000 | 150,000 | (12,913,725) | (2,742,836) | (14,006,561) |
| Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin: | | | | | |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | | |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | | | | |
| Transferimi në rezultatit e mbartur | | | (2,742,836) | 2,742,836 | - |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015 | 1,500,000 | 150,000 | (15,656,561) | (6,982,042) | (20,988,603) |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | | |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse: | | | | | |
| Transferimi në rezultatit e mbartur | | | (6,982,042) | 6,982,042 | - |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016 | 1,500,000 | 150,000 | (22,638,603) | 2,064,448 | (18,924,155) |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shqipërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Rina Albania Sh.p.k. më 24/03/2017 dhe janë firmosur si më poshtë:

Stefano Grigori
Administrator

Mazars

Mazars shpk

Hartues i Pasqyrave Financiare
Rr. Emin Duraku, Pall. "Birtaker",
Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

| Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|--|---|---|
| Flukset e parasë nga aktivitetet operative | | |
| Fitim / Humbja e vitit | 2,064,448 | (6,982,042) |
| <i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i> | | |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 53,523 | 67,653 |
| Shpenzimet financiare jomonetare | 16,320 | 519 |
| Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese: | | |
| Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit: | | |
| Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | 2,151,666 | 7,791,732 |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 1,619,394 | 19,899 |
| Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit | 157,296 | |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit | 6,062,647 | 897,761 |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | (82,410) | (34,000) |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | (82,410) | (34,000) |
| Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare | 5,980,237 | 863,752 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar | 4,439,244 | 3,625,318 |
| <i>Efkti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i> | (201,125) | (49,826) |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor | 4 10,218,356 | 4,439,244 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Rina Albania shpk" është themeluar si një kompani me përgjegjësi të kufizuar më 26.03.2009 e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Kapital Fillëstar prej 1,500,000 Lek. Kompania është një person juridik që vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare".

Shoqëria është e regjistruar me NIPT K91601020M. Selia e Shoqërisë ndodhet pranë Sheshi Skëndërbe, Pallati i Kulturës, Tiranë, Shqipëri.

Objekti i aktivitetit të kompanisë është kontrolli, testimi përfundimtar, inspektimi, vlerësimi, certifikimi dhe kryerja e veprimtarive kërkimore në lidhje me materiale, projekte, procese, teknologji, produkte dhe instalime në fushën portuale/detare, industriale, civile e ndërtimit, shëndetësisë, ushqimit, energjisë, financiare, transportit, ambientit dhe sektorë të tjerë dytësore përfshirë edhe fusha të tjera prodhimi si edhe ato të autorizuar dhe deleguara nga administrata publike dhe autoritete të tjera, etj.

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 2 punonjës (2015: 2 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjyqimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e Informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbahen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 2016 | 2015 |
|------------------|--------|--------|
| Euro/LEK | 135.23 | 137.28 |

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të Instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse në bankë. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë për llogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të për llogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, për afrohen me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|----------------------|----------------------|---------------------|
| Mobilje për zyren | Vlera e mbetur | 20 % |
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25 % |

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë njëdhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura Interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime Interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

3.7. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cillin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

3.8. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikslonin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.9. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga palja tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.10. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

RINA ALBANIA Sh.p.k.
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Mjete monetare në bankë | 10,215,940 | 4,431,004 |
| Mjete monetare në arkë | 2,416 | 8,240 |
| | <u>10,218,356</u> | <u>4,439,244</u> |

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|---------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Klientë | 5,401,517 | 7,436,773 |
| Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme | (3,388,482) | (3,388,482) |
| | <u>2,013,035</u> | <u>4,048,291</u> |

Lëvizjet në provigjione për borxhin e keq gjatë vitit paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Gjendja më 1 Janar 2016 | (3,388,482) | (3,808,902) |
| Zhvlerësimi i periudhës | - | - |
| Rimarrje e periudhës | - | 420,420 |
| Totali | <u>(3,388,482)</u> | <u>(3,388,482)</u> |

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme përbëhet nga Tatim Fitimi i Parapaguar. Ky zë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Tatim fitim i parapaguar | 1,003,700 | 1,003,700 |
| Të tjera kërkesa për t'u arkëtuar | 68,687 | - |
| | <u>1,072,387</u> | <u>1,003,700</u> |

7. Parapagime dhe Shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Shpenzime të periudhave të ardhme | 26,057 | 24,249 |
| | <u>26,057</u> | <u>24,249</u> |

RINA ALBANIA Sh.p.k.**Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në Lek)***8. Te tjera te arketueshme afatgjata**

Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-----------------------------|------------------------|------------------------|
| Garanci per ambjent me qera | 158,808 | 158,808 |
| | <u>158,808</u> | <u>158,808</u> |

9. Aktive Afatgjata Materiale

| | <u>Pajisje IT</u> | <u>Mobilje dhe Orendi</u> | <u>Total</u> |
|-----------------------------------|-------------------|---------------------------|------------------|
| Kosto | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2014 | 340,221 | 635,475 | 975,696 |
| Shtesa | - | 34,000 | 34,000 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | 340,221 | 669,475 | 1,009,696 |
| Shtesa | 82,411 | | 82,411 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 422,632 | 669,475 | 1,092,107 |
| Amortizimi i akumuluar | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2014 | 247,265 | 444,601 | 691,866 |
| Amortizimi i vitit | 23,239 | 44,416 | 67,655 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | 270,504 | 489,014 | 759,518 |
| Amortizimi i vitit | 17,429 | 36,094 | 53,523 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 287,933 | 525,108 | 813,042 |
| Vlera neto kontabël | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2014 | 92,956 | 190,877 | 283,833 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | 69,717 | 180,461 | 250,178 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 134,699 | 144,367 | 279,065 |

RINA ALBANIA Sh.p.k.
Shënimef e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|--------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Furnitorë | 9,179,567 | 9,054,028 |
| Furnitorë për fatura të pambërritura | 124,819 | 116,010 |
| | <u>9,304,386</u> | <u>9,170,038</u> |

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 11,448,854 | 9,787,459 |
| | <u>11,448,854</u> | <u>9,787,459</u> |

12. Te tjera detyrime

Llogaritë e pagueshme te tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-----------------------|------------------------|------------------------|
| Të pagueshme të tjera | 34,103 | - |
| | <u>34,103</u> | <u>-</u> |

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|---------------------------------|------------------------|------------------------|
| Tatim në burim | 203,232 | 154,107 |
| Detyrime për sigurime shoqërore | 53,546 | 53,384 |
| Shteti-TVSH për tu paguar | 113,171 | 40,363 |
| Tatim mbi të ardhurat personale | 40,019 | 38,921 |
| | <u>409,968</u> | <u>286,775</u> |

14. Hua Afat-Gjata

Në këtë zë është paraqitur hua-ja nga kompania mëmë Rina Internaional B.V. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|----------------|------------------------|------------------------|
| Hua Afat-gjatë | 11,494,550 | 11,668,800 |
| | <u>11,494,550</u> | <u>11,668,800</u> |

RINA ALBANIA Sh.p.k.
Shënimef e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

15. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 1,500,000 LEK i zotëruar 100% nga shoqëria mëmë Rina International B.V.

| | <u>31 dhjetor 2016</u> | <u>31 dhjetor 2015</u> |
|-------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Numri i pjesëve | 1,000 | 1,000 |
| Vlera nominale (në LEK) | <u>1,500</u> | <u>1,500</u> |
| Kapitali i nënshkruar | <u><u>1,500,000</u></u> | <u><u>1,500,000</u></u> |

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|--------------------------|---|---|
| Të ardhura nga shërbimet | <u>16,071,979</u> | <u>8,925,190</u> |
| | <u><u>16,071,979</u></u> | <u><u>8,925,190</u></u> |

17. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|---|
| Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare | (950,200) | (746,460) |
| Të ardhurat nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare | <u>933,879</u> | <u>745,941</u> |
| | <u><u>(16,320)</u></u> | <u><u>(519)</u></u> |

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

| | <u>31 dhjetor 2016</u> |
|---|--------------------------|
| Qarkullim i tatueshëm | 22,127,601 |
| Zbriten faturat auto-ngarkesë (Reverse-charge) | (6,055,622) |
| Shuma e qarkullimit e korrektuar | 16,071,979 |
| Zbriten diferencat e këmbimit të përfshira në të ardhura të tjera | (16,320) |
| Sipas Kontabilitetit | <u>16,055,659</u> |
| Diferenca | <u><u>-</u></u> |

18. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|--|--|--|
| Shpenzime nga aktiviteti shfrytëzimit | 4,216,113 | 3,127,059 |
| Shpenzime të tjera | 4,070,568 | 1,390,104 |
| Shërbime kontabiliteti | 791,059 | 804,245 |
| Shpenzime qeraje | 693,881 | 704,352 |
| Blerje energji, ujë, telefon, internet etj | 178,769 | 180,059 |
| Komisione bankare | 151,644 | 131,455 |
| | 10,102,034 | 6,337,274 |

19. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|---|--|--|
| Shpenzime page | 1,793,805 | 1,601,045 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 362,321 | 359,044 |
| | 2,156,126 | 1,960,089 |

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2016 është 2 (2015: 2 punonjës).

Shpenzimet e personelit deklaruar në Drejtorinë Tatimore janë 2,568,285 lekë. Mospërputhja me shumën 774,480 vjen si rezultat i shpenzimit të pagës bruto, për administratorin e cila llogaritet vetëm për efekt sigurimesh.

20. Amortizimi

Shpenzimi për amortizimin e asetëve të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohet si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 |
|----------------------|--|--|
| Shpenzime amortizimi | 53,523 | 67,653 |
| | 53,523 | 67,653 |

RINA ALBANIA Sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Vlerat janë në Lek)***21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Në këtë zë paraqitet shpenzimi për provizione për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 dhe detajohet si më poshtë:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|---|
| Shpenzime për mbyllje klienti (write -off) | (1,853,777) | (8,205,226) |
| Të ardhura të patatueshme (rimarrje provizioni) | - | 420,420 |
| | <u>(1,853,777)</u> | <u>(7,784,806)</u> |

22. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|--|---|---|
| Të ardhura/Shpenzime nga kursi i këmbimit nga aktiviteti financiar | 174,250 | 243,109 |
| | <u>174,250</u> | <u>243,109</u> |

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u> | <u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u> |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 2,064,448 | (6,982,042) |
| Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë) | 2,161,494 | 7,974,201 |
| Shpenzime të tjera | 307,717 | 189,395 |
| Shpenzime zhvleresimi (provizione) | 1,853,777 | 8,205,226 |
| Te ardhura te patatueshme | | (420,420) |
| Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura) | 4,225,942 | 992,159 |
| Humbje fiskale e mbartur | (4,390,316) | (5,382,475) |
| Fitim/Humbje Fiskale | (164,374) | (4,390,316) |
| Tatim fitimi @15% | | - |
| Fitimi Neto | 2,064,448 | (6,982,042) |

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | | 31 dhjetor 2015 | |
|---------------------------------------|-----------------|-------------------|-----------------|-------------------|
| | Të arkëtueshme | Të pagueshme | Të arkëtueshme | Të pagueshme |
| Rina International B.V | - | - | - | 213,152 |
| Rina SPA | - | 3,445,884 | - | 2,978,275 |
| Rina Services SPA | - | 4,777,401 | - | 3,431,389 |
| Rina Simtex Organismul De Certificare | | 3,225,570 | | 3,164,643 |
| Te tjera te pagueshme | | | | |
| Rina Simtex Organismul De Certificare | | | - | 109,944 |
| | - | 11,448,854 | - | 9,897,403 |
| <i>Hua</i> | | | | |
| Rina International B.V | - | 11,494,550 | - | 11,668,800 |
| Total | - | 11,494,550 | - | 11,668,800 |

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | | 31 dhjetor 2015 | |
|---------------------------------------|-----------------|------------------|-----------------|----------------|
| | Shitje | Blerje | Shitje | Blerje |
| Rina SPA | - | 514,159 | - | 512,079 |
| Rina Services SPA | - | 1,412,648 | - | - |
| Rina Simtex Organismul De Certificare | - | - | - | 109,944 |
| | - | 1,926,807 | - | 622,023 |

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

25. Angazhime dhe pasiguri

Me 31 dhjetor 2016 kompania kishte kontratë qeraje operative në lidhje me marrjen me qera të zyrës së ushtrimit të veprimtarisë në Tiranë. Minimumi i pagesave të ardhshme sipas kontratës është si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|-----------------|-----------------|
| Brenda një viti | 272,624 | 276,756 |
| Më shumë se një vit por më pak se pesë vite | | - |
| | 272,624 | 276,756 |

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare